



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

KRYESIA

VENDIM

Nr. 02 datë 18.02.2026


“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak të muajit Shkurt 2026”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 23, date 24/04/2020, neni 66, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 18 / 02 / 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet me datë 24.02.2026
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës se mbledhjes sipas dokumentit bashkelidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Evis Shimpaj)


Sekretari i Këshillit Bashkiak

(Andreas Çelepi)
